



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:247595
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05439880

Ac.nr.3611/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.Sh., nga fshati S..... e M....., Komuna e Fushë Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson kompania e avokatëve Arbëresh, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3049/2016 të datës 22.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3049/2016 i datës 22.03.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.3049/2016 të datës 22.03.2021, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit J.Sh., nga fshati S..... e M....., Komuna e Fushë Kosovës, dhe ka detyruar të paditurën K.S. “S.....”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për shpenzimet e mjekimit t’ia paguaj shumën prej 10,592.65 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga dita e parashtrimit të padisë me dt.12.12.2016, e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës civile në shumë prej 949.80 euro, në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, që ankesën ta aprovoj, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të refuzoj ankesën e palës së paditur dhe të vërtetoj aktgjykimin C.nr.3049/16 të datës 22.03.2021.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit material, në shumën prej 10,592.65 euro.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: kontrata për sigurimin kolektiv shëndetësor dhe për aksidentet personale të punëtorëve datë 22.12.2015, kopja e kartelës së sigurimit shëndetësor, fletëdalja nga Spitali Amerikan datë 08.10.2016, njoftimi i KS "S....." datë 30.11.2016 dhe datë 08.11.2016, njoftimi i Spitalit Amerikan datë 16.11.2016 dhe shkresa zyrtare e datës, parashtrësia për shqyrtim datë 08.11.2016 dhe specifikacioni i shpenzimeve, kopja e kuponëve fiskal të lëshuar nga Spitali Amerikan datë 08.10.2016, faturat tatimore të shitjes të lëshuara nga Spitali Amerikan për paditësin J.Sh., të datës 01.10.2016, kopjet e kuponave fiskal datë 30.09.2016, fatura tatimore e shitjes datë 29.09.2016, kopjet e kuponave fiskal të datës 07.10.2016, faturat e shitjes datë 06.10.2016, faturat datë 06.10.2016, 19.09.2016 dhe 05.10.2016, kopjet e kuponëve fiskal, kontrollat laboratorike së bashku me faturat e shpenzimeve dhe ekspertiza mjekësore nga dr. B.D., datë 10.01.2021. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të ekzistimit të bazës së kërkesëpadisë ka vendosur lidhur me aprovimin e të njëjtës duke u bazuar në dispozitat e nenit 918, 919, 940, 899 dhe 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452, paragrafi 2 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së

nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i paqartë dhe kundërthënës me arsyetimin dhe provat e administruara, faktet vendimtare janë të paqarta dhe kontradiktore. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Aktgjykimi përmban edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 919, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 919, paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: *“Ngjarja, duke marrë parasysh se për cilën kontraktohet sigurimi (rasti i siguruar) duhet të jetë i ardhshëm, e pasigurt dhe e pavarur nga vullneti ekskluziv i kontraktuesve”*. Sipas dispozitës së nenit 940, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kur paraqitet rasti i siguruar, siguruesi ka për detyrë të paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë në afatin e kontraktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se katërmbëdhjetë (14) ditë, duke llogaritur që nga data kur siguruesi të ketë marrë njoftimin se ka ndodhur rasti i siguruar”*. Në rastin konkret, në bazë të shkresave të lëndës rezulton se paditësi si punëtor i Kompanisë Autotransporti, ka qenë përfitues i plolisës së sigurimit shëndetësore dhe se e njëjta polisë ka qenë valide në periudhën kur paditësi i është nënshtruar kontrolleve mjekësore si dhe intervenimit kirurgjik.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës së plisa e sigurimit që posedon paditësi nuk mbulon operacionin me të cilin është operuar paditësi, pasi që sipas pikës 6 “pasoja e sëmundjes apo deformimeve kongjenitale (të lindura)” nuk i mbulon. Gjukata e Apelit gjen së në këtë rast, në bazë të shkresës së Spitalit Amerikan të datës 08.12.2016 si dhe njoftimit të datës 16.11.2016, është sqaruar diagnoza dhe lloji i sëmundjes së paditësit dhe fakti se stenoza e valvulës mitrale nuk është sëmundje kongjenitale. Po ashtu, edhe në bazë të ekspertizës mjekësore është konstatuar se stenoza e valvulës mitrale është sëmundje e cila fitohet gjatë jetës, me ç’rast valvula mitrale ngushtohet, deformohet, zvogëlohet arena e saj në 2 cm², dhe nuk e kryen funksionin e saj fiziologjik dhe për këtë arsye duhet që të zëvendësohet me valvulë artificiale.

Gjykata e Apelit e refuzoj si të pabazuar pretendimin ankimor të paditurës se eksperti nuk ka qenë në seancë për sqarime të ekspertizës së tij të punuar dhe se gjykata sipas detyrës zyrtare është dashur që të njëjtin ta ftoj në seancë për të dhënë sqarim të ekspertizës së punuar, gjë që nuk ka ndodhur. Në rastin konkret gjykata ankimore gjen se eksperti ka qenë i ftuar në seancën e datës 17.03.2021, dhe se në bazë të procesverbalit nga ana e gjykatës së shkallës së parë konstatohet se merr pjesë eksperti i mjekësisë dr. B.D., - kardiokirurg, mirëpo në këtë seancë për ta paditurën nuk ka prezantuar askush dhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt andaj, pretendimet për mos ftesën e ekspertit në seancë janë të paqëndrueshme.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3611/2021, me datë 05.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.